

Szunyog: Zgjedhjet
në veri ende janë
të rëndësishme

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


OPOZITA KËRKON ULJEN E TARIFAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE

FAQE 4-5

Deputetët e Kuvendit të Kosovës, në një seancë të jashtëzakonshme mbajtur të enjten, kanë debatuar për çmimin e energjisë elektrike. Vendimi për seancën e jashtëzakonshme është marrë të hënën në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, kurse kërkesa për këtë debat ka ardhur nga Partia Demokratike e Kosovës. Deputetët e opozitës kanë theksuar se bllok-tarifat që janë në fuqi, janë diskriminuese për konsumatorët, pasi kushdo që shpenzon mbi 800 megavate, paguan tre fish më shumë sesa ata që nuk e kalojnë këtë shifër të konsumit



AKTUALE



**BIE ÇATIA E NDËRTESES SË
KOMUNËS NË PRISHTINË, LËNDOHET
NJË PERSON** F. 7

**MBI 200 STUDENTË NGA
KOSOVA MUND TË STUDIOJNË
NË UNIVERSITETE PRESTIGJIOZE
HUNGAREZE VITIN TJETËR** F. 5

**PËR DY JAVË MINT-I PRANOI
462 ANKESA NGA QYTETARËT
PËR PARREGULLSITË NË TREC** F. 7


EKONOMI



**EKONOMIA NË TREND TË RITJES,
SHTYSAT DHE RREZIQET** F. 8

**BQK-ja: PAGESAT NË KOSOVË
DO TË KRYHEN VETËM ME EURO** F. 8

SPORT



**GAZETA 'AS' PËR ZHEGROVËN: ËSHTË
NJË NGA SENSACIONET NË FRANCË**

F. 10



**AVOKATI SERB ÇEDOMIR STOJKOVIQ
BËN HOMAZHE TE VARRI I BLERINA
JASHARIT, IA LË NJË LETËR** F. 5

**AAK-ja DHE NISMA BËHEN
BASHKË PËR ZGJEDHJET
PARLAMENTARE** F. 3



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Buniamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zelensky: Mungesa e ndihmës për Ukrainën nënkupton krizë për Evropën

DAVOS, 18 JANAR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka paralajmëruar për rreziqe të tjera nëse vonohet ndihma e Perëndimit për shtetin e tij, i cili është duke u përballur me pushtimin rus për gati dy vjet. “Do të jetë një krizë masive për gjithë Evropën”, ka thënë Zelensky para gazetarëve në Forumin Ekonomik Botëror që po mbahet në Davos të Zvicrës. “Ukraina do të vazhdojë luftën, mirëpo pa ndihmë financiare Rusia do të mund të mposhtë Ukrainën. Në momentin që mposht Ukrainën, do të jetë lufta në mes të NATO-s dhe Rosisë”, ka thënë Zelensky. Sipas tij, presidenti rus Vladimir Putin e ka në mendje një sulm të tillë

kundër aleancës ushtarake.

Mes të tjerash, presidenti ukrainas ka përmendur se pasoja direkte e mungesës së ndihmës së Perëndimit do të jetë dobësimi në fushëbetejë për shkak të mungesës së artilerisë. “Në rast të humbjes së Ukrainës, Evropa jo vetëm që do të kërcënohet nga valë të reja refugjatësh, por do të ndalen edhe furnizimet me grurë dhe rrymë”, ka paralajmëruar Zelensky.

Ukraina është duke e luftuar pushtimin rus për gati dy vjet me anë të ndihmës së Perëndimit. Sipas të dhënave të Institutit për Ekonomi Botërore, Kiel, Ukraina ka pranuar ndihmë totale në vlerë të 240 miliardë dollarëve.



Megjithatë, siguri i ndihmës së re në vlerë të miliarda dollarëve është kyç për vazhdim të mbrojtjes së territorit.

Shtetet e Bashkuara, të cilat kanë ndihmuar më së shumti Ukrainën që prej nisjes së luftës, aktualisht përballen me bllokadë të disa

republikanëve konservatorë të cilët kanë dalë kundër ndarjes së mëtejshme të ndihmës për këtë shtet.

Edhe Bashkimi Evropian nuk ka arritur të ndajë fonde në vlerë të 50 miliardë dollarëve për Ukrainën për shkak të vetos që e ka përdorur Hungaria.

Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën “operacion special ushtarak” për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Rosisë duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Pakistani, sulme hakmarrëse ndaj Iranit

ISLAMABAD, 18 JANAR - Avionët luftarakë të Pakistanit kanë kryer sulme ajrore mëngjesin e 18 janarit ndaj caqeve të supozuara militante në Iranin fqinj. Sipas zyrtarëve lokalë iranianë, në këto sulme janë vrarë katër fëmijë dhe tri gra.

Sulmet në provincën Sistan-Baluçistan vijnë pasi Garda Revolucionare Islamike e Iranit sulmoi provincën jugperëndimore pakistaneze të Baloçistanit më 16 janar, duke vrarë dy fëmijë.

Ministria e Jashtme e Pakistanit tha përmes një deklarate se sulmet shënjestruan bazat e “terroristëve”. “Mëngjesin e sotëm Pakistani kreu një sërë sulmesh të koordinuara dhe të sakta ushtarake kundër vendeve ku strehohen terroristët në provincën Sistan-Baluçistan të Iranit. Një numër i terroristëve u vranë gjatë operacionit”, u tha në deklaratë. Një zyrtar nga kjo provincë e Iranit



tha për agjencinë e lajmeve “Mehr” se sulmet goditën një fshat kufitar dhe se viktimat ishin gra dhe fëmijë. “Në orën 4:50 të mëngjesit disa shpërthime janë dëgjuar në zonën e qytetit Saravan dhe pas hetimeve, ne gjetëm se Pakistani shënjestroi me raketa një prej fshatrave kufitare të Iranit”, tha zyrtari nga Sistan-Baluçistan,

Alireza Marhamati.

“Tri gra dhe katër fëmijë janë vrarë”, tha Marhamati në një prononcim për agjencinë e lajmeve “Mehr”.

Mediet iraniane raportuan se pas sulmit, i dërguari me punë i Pakistanit u thirr në bisedë nga Ministria e Jashtme në Teheran. Në Pekin, zëdhënësja e Ministrisë

së Jashtme tha se Kina është e gatshme t’i ndërmjetësojë bisedimet mes Iranit dhe Pakistanit. “Pala kineze singërisht shpreson që të dyja palët mund të përmbahen dhe të shmangin një përshkallëzim të tensioneve”, tha zëdhënësja Mao Ning.

Sulmet hakmarrëse ajrore të Pakistanit ndodhën disa orë pasi

Islamabadi tërhoqi ambasadorin e tij nga Irani në shenjë proteste ndaj sulmit të kryer nga Garda Revolucionare Islamike e Iranit.

Garda Revolucionare Islamike e Iranit tha se sulmet e 16 janarit në Baloçistan u kryen ndaj grupit militant sunit Jaish al-Adl.

Irani dhe Pakistani ndajnë një kufi prej 900 kilometrash dhe kontrolli i tij ka qenë i vështirë, duke u mundësuar disa grupeve militante, veçmas ato që kanë ideologji nacionaliste baluçe, të operojnë në zonë.

Më 16 janar Iraku tërhoqi të dërguarin në Teheran, pasi disa civilë u vranë gjatë sulmeve rakitore të Gardës iraniane në Irbil.

Irani ka pretenduar se sulmet e 16 janarit shënjestruan një “seli të spiunëve izraelitë” afër Konsullatës amerikane në Irbil të Irakut dhe caqe të lidhura me grupin militant, Shteti Islamik, në veri të Sirisë.

Ekskavatorët rrafshojnë shtëpitë e sapondërtuara në Angli pas zbulimit të ‘gabimeve në ndërtim’

LONDËR, 18 JANAR - Banorët e një zone më shtëpi të sapondërtuara në verilindje të Anglisë janë tmerruar nga shkatërrimet e dhjetëra prej strukturave pas zbulimit të gabimeve që detyruan prishjen e tyre.

Shtëpitë e reja në Cambridgeshire raportohet se janë të mbushura me krisje të thella dhe rezidentët e vendosur tashmë aty tremben se edhe shtëpitë e tyre i pret i njëjti fat.

Ndërtuesit Barratt David Wilson pranonin se disa prej shtëpive ishin ndërtuar me themele të paplota dhe 36 prej tyre duhet të shemben e rindërtohen.

Shembjet kanë nisur dhe pritët të

vazhdojnë për 12 javë duke shkaktuar probleme për banorët e rinj me zhurmën dhe pluhurin e shembjeve.

43-vjeçari Christian Sutherland tha për rrjetin “The Sun” se i biri katërvjeçar ka qenë në spital prej mangësisë së frymëmarrjes. “Pluhuri që ngrihet këtu është i frikshëm. Ne po mundoheshim të stabilizoheshim në shtëpitë e reja dhe diçka e tillë nuk na ndihmon. Duket se zyrtarët bashkiakë nuk duan t’ia dinë dhe u lënë në dorë gjithçka ndërtuesve”, tha ai.

Zona e re kishte leje për 1 593 shtëpi banimi, një shkollë fillore, një supermarket, një librari dhe

ambiente sportive.

61-veçari Mark Wells thotë se ka paguar 650 000 paundë për shtëpinë e tij të re me katër dhoma gjumi. “Ne u shqetësua në fillim, por më pas na thanë se ato të fazës së parë janë në rregull. Shtëpitë e prekura kishin çarje të mëdha”, ka treguar ai.

Ndërtuesit thanë se kërkojnë ndjesë ndaj klientëve, por shembja e shtëpive është mënyra më efektive e veprimit, shkruan rrjeti “TheSun”, raporton TCh. “Ne po bëjmë ç’është e mundur për t’i zbutur pasojat e incidentit. Më e rëndësishmja është që shtëpitë të jenë të cilësisë sa më të mirë”, shtonin ata.



AAK-ja dhe Nisma bëhen bashkë për zgjedhjet parlamentare

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 JANAR - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nisma Socialdemokrate kanë zyrtarizuar koalicionin parazgjedhor për zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Pas nënshkrimit të koalicionit nga dy liderët e partive politik është publikuar edhe deklarata e përbashkët politike për lidhjen e koalicionit. "Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nisma Socialdemokrate, krijojnë rreshtin (Frontin) e përbashkët për shtetin e Kosovës, në aleancë me gjithë ata që janë kundër degradimit të saj dhe në partneritet me aleatët strategjikë që i patëm pranë në momentet më kritike të historisë sonë! Me qëllim që të mos lejojmë rrezikimin e pavarësisë së vitit 2008; Me qëllim të mbrojtjes së karakterit unitar të shtetit; Me qëllim të arritjes së marrëveshjes me Serbinë në pajtueshmëri të plotë me Kushtetutën e Republikës Kosovës; Me qëllim që ta ndërpresim degradimin e mëtutjeshëm të marrëdhënieve me ShBA-në dhe BE-në, që janë garanci e paqes, sigurisë dhe prosperitetit për tërë Ballkanin Perëndimor; Ashtu siç ishim të vendosur për krijimin e Ushtrisë së Kosovës, sot jemi të vendosur për anëtarësimin e plotë në



NATO; Me qëllim që t'i japim fund logjikës së funksionimit dhe kontrollit partiak neokomunist dhe të kthimit të Kosovës në kursin euro-atlantik; Me qëllim që t'i japim fund logjikës që nxit konfliktet e vazhdueshme brenda shoqërisë sonë dhe ta promovojmë bashkërenditjen e

energjiave tona kombëtare e shoqërore në interes të përgjithshëm, pajtohemi që Aleanca dhe Nisma të krijojmë një front të përbashkët politik dhe ftojmë të gjitha partitë politike, nismat qytetare, shoqatat, grupet e ndryshme të interesit, intelektualë të profileve të

ndryshme dhe të gjithë ata që janë të bindur në domosdoshmërinë e bashkimit të forcave dhe energjiave kombëtare dhe shoqërore, që të bashkohen në këtë front për t'i dhënë fund rrezikut që i kanoset shtetit të Kosovës nga kjo qeverisje e keqe, e t'i kthehemi normalitetit,

zhvillimit dhe prosperitetit si shtet e si komb. Vetëm të bashkuar mund ta ndalim të keqen dhe të hapim perspektiva për një jetë të sigurt, të begatshme dhe në harmoni e ku do të respektohet dinjiteti i çdo qytetari të Kosovës", është thënë në deklaratën politike të AAK-së dhe të Nismës.

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se ky koalicion është bërë pasi është vlerësuar se qytetari i Kosovës ka mbetur i papërfaqësuar, është lënë i vetëm e në raste të caktuara edhe është luftuar prej qeverisë dhe kryeministrit Albin Kurti.

"A dëshirojmë ta lëmë qytetarin e Kosovës vetëm dhe pa përkujdesje? A dëshirojmë ta shohim Kosovën me më pak njerëz? Po e them atë shprehjen e famshme, jemi të varfër, sepse qeveria është e pasur. Pra buxheti i Kosovës mbahet në bunker nga qeveria Kurti dhe nuk investohet", ka thënë Haradinaj.

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka theksuar se bashkë me kryetarin Haradinaj vijnë me një projekt të ri, të përbashkët, i cili veç ka nisur e është i hapur. Ai i ka ftuar të gjithë ata njerëz që mendojnë se Kosova më shumë se kurrë ka nevojë t'i bashkojë energjitë. "Tash është koha për t'i dhënë një dinamikë të re vendit", ka thënë Limaj.

Szunnyog: Zgjedhjet në veri ende janë të rëndësishme

PRISHTINË, 18 JANAR - Shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunnyog, mirëpriti vendimin e serbëve në Kosovë që ta shfrytëzojë të drejtën e tyre demokratike dhe kornizën ligjore për të mbledhur nënshkrime për petitionin për shkarkimin e kryetarëve shqiptarë në Mitrovicë të Veriut dhe Leposaviq. Ai u ka bërë thirrje autoriteteve lokale dhe qendrore t'ua ofrojnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm grupeve nismëtare që ta iniciojnë petitionin edhe në dy komunat e tjera në veri të Kosovës, Zvečan dhe Zubin Potok, të banuara me shumicë serbe.

Në Mitrovicë të Veriut dhe Leposaviq më 17 janar nisi mbledhja e nënshkrimeve, ndërsa turma e njerëzve, e nisur drejt vendeve ku po mbledheshin nënshkrimet për petitionin, u udhëhoq nga zyrtarët e Listës Serbe, partisë kryesore të serbëve në Kosovë, që gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar.

Mbledhja e nënshkrimeve ka vazhduar edhe më 18 janar. "Mbajtja e shpejtë e zgjedhjeve të parakohshme lokale në veri të Kosovës, me pjesëmarrjen e pakushtëzuar të serbëve të Kosovës, mbetet e rëndësishme", ka shkruar ai në platformën "X".



Petitioni për shkarkimin e kryetarëve shqiptarë vjen pasi serbët bojkotuan zgjedhjet lokale të mbajtura prillin e vitit të kaluar përmes të cilave u zgjedhën kryetarët shqiptarë.

Popullsia serbe në veri nuk i pranoi kryetarët shqiptarë dhe pasuan krizat të përcjella me rritjen e tensioneve. Më pas komuniteti ndërkombëtar kërkoi shpalljen e zgjedhjeve të

jashtëzakonshme, kërkesë që u pranua nga Qeveria e Kosovës, e cila në shtator të vitit 2023 miratoi një udhëzim administrativ që mundëson shkarkimin e kryetarit të komunës.

Në mënyrë që petitioni të jetë i suksesshëm, kërkohet të mbledhen të paktën 20 për qind e nënshkrimeve nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar në komunat përkatëse.

Sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që petitioni të jetë i suksesshëm, që më pas do t'i hapte rrugë shkarkimit të kryetarëve, në Mitrovicë të Veriut duhet të mbledhen të paktën 3 640 nënshkrime, në Leposaviq 2 689, në Zubin Potok 1 347 dhe në Zvečan 1 411 nënshkrime.

Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ka deklaruar javën e kaluar se


qytetarët në Mitrovicë të Veriut, Leposaviq dhe Zubin Potok kanë afat që deri më 22 janar t'i mbledhin nënshkrimet. Ky afat do të jetë më i gjatë për pesë ditë për qytetarët e Zveçanit, pasi që në KQZ është dorëzuar më vonë kërkesa për ta marrë listën me numrin e saktë të votuesve të regjistruar në këtë komunë.

Nëse KQZ-ja konfirmon rezultatin e petitionit, pastaj organizohet votimi për shkarkimin e kryetarit, që duhet të mbahet brenda 45 ditëve. Që ky votim të jetë i suksesshëm, kërkohen 50 për qind, plus një votë e qytetarëve me të drejtë vote.

Pas kësaj, rezultati i dërgohet presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, e cila ka një afat ligjor nga 30 deri në 45 ditë për ta shpallur mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme.

Marrja e mandatit nga kryetarët e rinj shqiptarë rriti tensionet në veri majin e vitit të kaluar dhe në Zvečan situata u përshkallëzua, pasi që serbët u përleshën me pjesëtarët e misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR.

Komuniteti ndërkombëtar ka kërkuar shtensionimin e situatës dhe shpalljen e zgjedhjeve të reja në veri.



Opozita kërkon uljen e tarifave të energjisë elektrike

Deputetët e Kuvendit të Kosovës, në një seancë të jashtëzakonshme mbajtur të enjten, kanë debatuar për çmimin e energjisë elektrike. Vendimi për seancën e jashtëzakonshme është marrë të hënën në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, kurse kërkesa për këtë debat ka ardhur nga Partia Demokratike e Kosovës. Deputetët e opozitës kanë theksuar se bllok-tarifat që janë në fuqi, janë diskriminuese për konsumatorët, pasi kushdo që shpenzon mbi 800 megavate, paguan tre fish më shumë sesa ata që nuk e kalojnë këtë shifër të konsumit

ta ulin çmimin e energjisë “në harmoni me rrethanat socio-ekonomike dhe nivelin e çmimit të energjisë në tregun ndërkombëtar”. Po ashtu, aty kërkohet të bëhet anulimi i bllok-tarifës për konsumatorët familjarë. Ndërkaq, nga qeveria kërkohet të ndërmarë masa për “krijimin e parakushteve financiare për anulimin e menjëhershëm të vendimit për shtrenjtimin e energjisë elektrike dhe lehtësimin e barrës financiare për konsumatorët familjarë të energjisë elektrike”. Mimoza Kusari-Lira, shefe e grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje në pushtet, tha se ekzekutivi po punon për gjetjen e zgjidhjes për situatën në sektorin energjetik. Megjithatë, ajo kritikoi draft-rezolutën e opozitës. “Rezoluta e prezantuar nuk është serioze dhe nuk kontribuon në ofrimin e zgjidhjes. Kjo nuk është risi në vetvete, pasi zgjidhjet që i keni ofruar në vazhdimësi kanë qenë seancat e jashtëzakonshme për gjendjen në sektorin e energjisë, komisione hetimore për sektorin e energjisë. Ndërkaq, në vazhdimësi, keni abstenuar në votime në vendimmarrje për

zhvillimin e politikave në sektorin e energjisë”, tha Kusari-Lila, duke shtuar se Lëvizja Vetëvendosje nuk do ta përkrahë këtë rezolutë. Deputeti i LDK-së, Besian Mustafa, kritikoi qeverinë e Albin Kurtit nga Lëvizja Vetëvendosje që, sipas tij, gjatë tre vjetëve në pushtet ka bërë që me shpejtësi “të rriten çmimet e çdo produkti” dhe inflacioni i lartë, sipas tij, e ka bërë “koston e jetesës të papërbalueshme për shumicën e qytetarëve”. “Çfarë bëri kjo qeveri për t’i rritur kapacitetet e gjenerimit të energjisë? Asgjë. Zero. Një megavat të vetëm nuk e shtoi mbi tre vjet qeverisje. Nëse kjo do të ishte një garë e shteteve në Ballkan, Kosova jonë do të ishte ende e shtangur në vijën e nisjes duke qëndruar e duke vrotuar të tjerët duke hapëruar përpara e ne duke mos lëvizur një hap të vetëm”, tha ai. Bllok-tarifat që janë në fuqi, sipas shefit të grupit parlamentar të AAK-së, Besnik Tahiri, janë diskriminuese për konsumatorët, pasi kushdo që shpenzon mbi 800 megavate, paguan trefish më shumë sesa ata që nuk e kalojnë këtë shifër të

konsumit. “Në momentin që ne do ta dërgojmë në Gjykatën Kushtetuese, që të adresohet prej kontekstit të të drejtave të njeriut, ne do ta fitojmë rastin”, tha ai. Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, tha se gjatë qeverisë Kurti ka pasur subvencionime të qytetarëve dhe bizneseve për energjinë e konsumuar. Sipas saj, për dy vjet është ulur konsumi i energjisë nga amvisëritë dhe është rritur ai i bizneseve që, sipas saj, është “reflektim i rritjes së aktivitetit ekonomik”. Rizvanolli tha se në thelb çështja e bllok-tarifave është çështje e drejtësisë sociale. Ajo gjatë seancës plenare trajtoi edhe çështjen e rritjes së shpenzimit të energjisë gjatë dy muajve të fundit të vitit 2023. “Në muajin nëntor 2023 80 për qind e amvisërive kanë konsumuar nën 800 kilovatë orë, ndërsa 90 për qind kanë konsumuar më pak se 1 000 kilovatë orë. Pra, vetëm 10 për qind kanë konsumuar mbi 1 000 kilovatë orë dhe ky 10-përqindësh ka konsumuar 25 për qind të energjisë totale të konsumuar. Në muajin dhjetor ka pasur rritje prej 49-përqindësh të konsumit të amvisërive në

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 18 JANAR - Përmes një draft-rezolute, tri partitë opozitare në Kosovë kanë kërkuar uljen e tarifave të energjisë elektrike për konsumatorët në Kosovë. Ferat Shala nga Partia Demokratike e Kosovës, i cili ka paraqitur draft-rezolutën pesëpikëshe të kësaj partie dhe dy subjekteve të tjera opozitare, Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, tha se çmimet e rrymës janë “të papërbalueshme” për

qytetarët. “Kjo rritje e çmimit është e papërbalueshme, prandaj duhet zbritur kjo tarifë sepse energjia përfshihet në grupin e produkteve të nevojshme për konsum si buka, kripa, uji, vaji etj. Prandaj edhe çmimi duhet të bëhet i përbalueshëm”, tha Shala gjatë seancës së jashtëzakonshme plenare më 18 janar. Sipas Shalës, për dy vjet Zyra e Rregullatorit të Energjisë Elektrike (ZRRE) dhe Qeveria e Kosovës shtrenjtuan çmimet e rrymës. Përmes draft-rezolutës po kërkohet që ZRRE-ja dhe qeveria

Avokati serb Çedomir Stojković bën homazhe te varri i Blerina Jasharit, ia lë një letër

SKENDERAJ, 18 JANAR - Çedomir Stojković, avokat i politikanit serb Nikola Sandulović, ka vendosur lule te varri i Blerina Jasharit, vajzës shtatëvjeçare të vrarë në Prekaz nga forcat ushtarake dhe policore serbe. Stojković ka lënë edhe një letër pranë varrit të shtatëvjeçares, në të cilën shkruan për kërkimfalje. "Urrejtja vdes. Ti jeton përgjithmonë. Një mijë lot për një mijë vjet paqe. Dhe miliona shpresa dhe ëndrra. Të cilat fillojnë me fjalën 'Më fal'", është thënë në letërën e lënë nga Stojković në tri gjuhë. Stojković pati paralajmëruar se do të shkojë të vendosë lule te varri i shtatë vjeçes e cila është vrarë krah anëtarëve të tjerë të

familjes Jashari nga forcat e armatosura serbe në vitin 1998. Stojković ka shkruar se pas këtij veprimi do të dorëzohej tek autoritetet e Beogradit për t'i sfiduar dhe treguar se në Serbi ekziston një rregull i ri, sipas të cilit, çdo vendosje lulesh në varret e fëmijëve shqiptarë dënohet me rrahje dhe burg. Nikola Sandulović është arrestuar dhe ka thënë se është rrahur nga shërbimi sekret serb pikërisht për këtë arsye. Në fletarrestimin e tij thuhej se ai kishte nxitur urrejtje kombëtare, racore dhe fetare, duke e përmendur rastin kur kishte bërë homazhe te varrezat e familjes Jashari në Prekaz.



Mbi 200 studentë nga Kosova mund të studiojnë në universitete prestigjioze hungareze vitin tjetër



PRISHTINË, 18 JANAR - Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit ka nënshkruar të enjten memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të Tregtisë së Hungarisë për Programin e Bursave Stipendium Hungaricum për vitet 2024-2026. Qëllimi i këtij memorandum është ta lehtësojë dhe zgjerojë bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve, duke kontribuar kështu në një bashkëpunim reciprokisht të dobishëm në fushën e arsimit të lartë. 225 studentë nga Kosova do të kenë mundësi të studiojnë në universitete prestigjioze hungareze duke nisur nga viti akademik 2024/2025. Ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci, ka falënderuar Qeverinë e Hungarisë për mbështetjen financiare të studentëve nga Kosova ndër vite, me theks

mbështetjen e cila pritet të ofrohet përmes këtij memorandum bashkëpunimi për vitet e ardhshme. Ajo ka thënë se përgatitja e kuadrove në fusha të caktuara me interes për shoqërinë është shumë e rëndësishme për zhvillimin e gjithëmbarshtëm të vendit. Ndërsa ambasadori i Hungarisë, Bela Boszik, ka falënderuar ministrin për gatishmërinë e saj për ta thelluar bashkëpunimin dhe është zotuar për bashkëpunim më të gjerë në fushën e arsimit. Në kuadër të këtij programi, Hungaria do të ofrojë çdo vit 75 bursa bachelor, master dhe PhD për studentët nga Kosova që duan të studiojnë në universitetet hungareze në drejtimet bujqësi, shkenca shoqërore, shkenca natyrore, arte dhe shkenca të humanizmit, art dhe dizajn etj.

përgjithësi. Pasi t'i heqim orët pa konsum, 59 për qind nuk kanë kaluar pragun prej 800 kilovatësh orë, ndërsa 73 për qind nuk e kanë kaluar konsumin prej 1 000 kilovatësh orë", tha ajo. Tarifat e fundit të energjisë janë miratuar në prillin e vitit të kaluar. Për konsumatorët që shpenzojnë deri në 800 kilovatë në orë brenda një muaji, çmimi gjatë ditës është 7.79 centë për kilovat, ndërsa për ata që shpenzojnë më shumë se 800 kilovatë, pjesa mbi këtë u llogaritet me çmim prej 14.45 centësh. Nga ora 22:00 deri në 7:00 të mëngjesit çmimi për kilovat është 3.34 centë për ata që shpenzojnë deri në 800 kilovatë dhe 6.81 centë për atë që shpenzojnë më shumë.

KMDLNj-ja: Keqpërdorime të mëdha me faturat e rrymës, askush nuk ndihet përgjegjës

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka theksuar se qytetarët e Kosovës janë plaçkitur brutalisht nga ZRrE, KESCO dhe duken segmente të caktuara institucionale me faturat e fundit që, në jo pak raste, janë 400 për qind më të larta se ato të muajit paraprak. KMDLNj-ja ka pohuar se menjëherë ka kërkuar që Prokuroria e Shtetit të bëjë hetime sipas detyrës zyrtare, që qytetarët të mos i paguajnë faturat e plota, të ankohen në KESCO, të ngrenë padi në gjykata dhe të

kundërshtojnë në mënyrë të organizuar përmes protestave. Gjithashtu, KMDLNj-ja ka kërkuar nga deputetët t'i mbrojnë interesat e të gjithë qytetarëve të Kosovës pavarësisht prej bindjeve politike, partive, përkatësisë nacionale apo statusit në shoqëri. "Në rrethana normale kjo seancë është dashur të thirret nga pozita. Në fakt, pozita po e kundërshton këtë seancë dhe me çdo kusht po përpiqet ta arsyetojë këtë hajni të pashembullt që iu bëhet qytetarëve/votuesve të Kosovës. Me vet faktin se në seancën e jashtëzakonshme dolën pohimet se rryma që e blenë KESCO nga KEK me 2 euro e 90 centë ndërsa ua faturon qytetarëve 14 euro e 45 cent është fakt i mjaftueshëm që të bëhen hetimet e shpejta duke filluar nga ZRrE që është

koka e meduzës së keqpërdorimeve e deri te KESCO që është finalizuesi i keqpërdorimeve përmes faturave të fundit. Në këtë mes do të gjendej edhe përgjegjësia institucionale. 100 eurot e ndara nga Qeveria kanë qëllim për mbyrtje të zhurmës ndërsa subvencionimi ka filluar vetëm pasi pati reagime të shumta dhe për t'i shmangur kundërshtimet e organizuara të qytetarëve që janë vjedhur haptas nga ZRrE, KESCO dhe ka dyshime edhe nga segmente të caktuara institucionale", është thënë reagimin e KMDLNj-së. KMDLNj-ja ka theksuar se ka kundërshtuar këtë keqpërdorim të pamohueshëm duke kërkuar hetime dhe përgjegjësi sikur që e ka kundërshtuar diskriminimin e

qytetarëve/konsumatorëve në baza etnike si shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut. Në këtë kontekst, KMDLNj-ja ka kundërshtuar takimin me ZRrE-në sepse, sipas saj, pikërisht ky rregullator ka përgjegjësinë kryesore profesionale, institucionale dhe, mbase, edhe penale për situatën e krijuar. "KMDLNj thërret qytetarët e dëmtuar të këmbëngulin në mbrojtje të të drejtave të tyre duke shfrytëzuar çdo mundësi ligjore që e kanë si dhe protestat e organizuara si e drejtë demokratike dhe e drejtë e njeriut. Masat që i ka ndërmarrë qeveria, si rrethanë e reagimit qytetar, nuk e zgjidhin problemin, por e zbusin në periudhën afatshkurtër", është theksuar në reagimin e KMDLNj-së.

Vlerësohet puna njëvjeçare e kontratës sociale nëpër komuna

PRIZREN, 18 JANAR - Kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj, ka marrë pjesë të enjten në konferencën “Fuqizimi i kontratës sociale lokale” të organizuar nga aktiviteti i USAID-it Kontrata Sociale, në të cilën kanë marrë pjesë

përfaqësuesit e grupeve të qytetarëve dhe zyrtarët komunalë të pesë komunave që një vit më parë nënshkruam zotimin për agjendën e kontratës sociale. Qëllimi i kësaj konference ishte vlerësimi i progresit

njëvjeçar dhe caktimi i planit për këtë vit në kuadër të kësaj agjende, që ka mision forcimin e partneritetit mes qeverisjes lokale dhe qytetarëve, në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetës së tyre.



Kompleksi i Kullave të Isë Boletinit në Boletin të Zveçanit po trajtohet me prioritet

MITROVICË, 18 JANAR - Ministria e Kulturës ka njoftuar se Kompleksi i Kullave të Isë Boletinit në Boletin të Zveçanit po trajtohet me prioritet. MKRS-ja ka njoftuar se ka nisur dy programe për këtë kompleks të rëndësishë monumentale për popullin shqiptar: kurimi profesional i ekspozitës së përhershme muzeore dhe funksionalizimi i saj përmes menaxhimit e aktiviteteve të rregullta. Në këto dy programe MKRS-ja parashihet të investojë afër 185 mijë euro. “Në kuadër të programit të parë planifikohet vendosja e ekspozitës së përhershme në Kompleksin e Kullave të Isë Boletinit. Konkretisht do të bëhet realizimi i shërbimeve për zhvillimin e

projektit të revitalizimit dhe kurimin e ekspozitës dhe rifunksionalizimin e muzeut ekzistues. Ndërkaq, programi i dytë është projekti trevjeçar të cilin do ta implementojë organizata ‘Mundësia’. Programi ka vlerë totale financiare prej 135 mijë eurosh. Parashihet realizimi i aktiviteteve që do të funksionalizojnë këtë monument të trashëgimisë, si: uebfaqja e Kompleksit të Kullave, audioguidat, realizimi i programeve artistike, shënimi i datave të rëndësishme me aktivitete të veçanta, promovimi i kompleksit, organizimi i konferencave shkencore dhe një varg aktiviteteve të tjera që do të realizohen në kuadër të këtij programi”, ka njoftuar MKRS-ja.



KEDS-i bëri 100 mijë kontrole të keqpërdorimeve të rrymës gjatë vitit 2023

PRISHTINË, 18 JANAR - Luftimi i keqpërdorimit të energjisë elektrike nga KEDS-i vazhdon të mbetet prioritet i rëndësishëm me qëllim të minimizimit të humbjeve në rrjet. Sipas KEDS-it, vjedhja e energjisë elektrike nga konsumatorë të papërgjegjshëm nuk është vetëm akt i shëmtuar moral, por po afekton edhe ngarkesë të madhe në rrjetin elektroenergetik. Mbi të gjitha, mbart rreziqe të mëdha keqpërdoruesin. “Pajisje moderne teknologjike anti-vjedhje, të përcjella me një përkushtim të madh të ekipeve të kontrollit të KEDS-it janë aplikuar dhe po vazhdojnë të aplikohen me të madhe kundër keqpërdorimit të energjisë elektrike. Përgjatë tërë vitit 2023, në tërë Kosovën, në baza



ditore janë angazhuar rreth njëqind punëtorë, të cilët kanë kryer mesatarisht 400 kontrole në ditë. Për periudhën janar-

dhjetor 2023 janë bërë gati 100 mijë kontrole”, ka njoftuar KEDS-i, duke shtuar se përmes fushatës së vazhdueshme,

‘Rryma t’kushton ma lirë’, KEDS-i ka informuar të gjithë konsumatorët për pasojat që mund t’i ketë kushdo që mëton ta keqpërdorë energjinë elektrike. Kjo nënkupton se konsumimi legal i rrymës kushton më lirë sesa ndëshkimet që pasojnë kur dikush kapet duke e keqpërdor atë. “Rryma t’kushton më lirë sesa: rikthimi i humbjeve të shkaktuara ndaj kompanisë që llogaritet deri në gjashtë muaj për konsumatorët shtëpiakë dhe deri në dymbëdhjetë muaj për konsumatorët; kallëzimi penal në gjykatë, meqë keqpërdorimi i rrymës hyn në kuadër të ‘vjedhjes së shërbimeve’, e cila, sipas nenit 314 të Kodit Penal, është e dënueshme deri në tri vjet burg. KEDS-i mbetet i përkushtuar që

përgjatë këtij viti ta bëjë shtimin e kontroleve për keqpërdorime të energjisë elektrike me qëllim të identifikimit të keqpërdoruesve të saj dhe minimizimit të humbjeve në rrjet. U bëjmë thirrje të gjithë konsumatorëve tanë që ta konsumojnë energjinë elektrike në mënyrë të ligjshme, sepse kjo është mënyra e vetme dhe e drejtë kur asnjëri nuk ballafaqohet me pasojat që mund t’ua sjellë kur kapen duke e vjedhur atë. Shfrytëzojmë rastin t’i falënderojmë të gjithë qytetarët që raportuan raste të shumta të dyshimta të keqpërdorimit të energjisë elektrike përmes kanaleve tona të komunikimit dhe i ftojmë sërish të jenë bashkëpunues, sepse vetëm kështu mund të kontribuojmë për një shoqëri të ndërgjegjshme”, ka njoftuar KEDS-i.

457 kadetë policorë nënshkruajnë kontratat

PRISHTINË, 18 JANAR - Policia e Kosovës, me rastin e përfundimit me sukses të procedurave testuese për kandidatët që i janë nënshtruar procesit të rekrutimit në konkursin e fundit për zyrtar policor, me datë 17 dhe 18 janar

2024, në katër grupe të ndara, ka organizuar nënshkrimin e kontratave për lidhje të marrëdhënies së punës me Policinë e Kosovës për pozitën kadet policor. Pritet që Policisë së Kosovës t’i bashkëngjitet gjenerata

më e re (gjenerata e 59) e kadetëve policorë në përbërje prej 457 kadetë policorë, prej tyre 354 meshkuj dhe 103 femra, të cilët iu përkasin etnive të ndryshme: shqiptar, serb, boshnjak, turq, ashkalinj, egjiptian dhe romë.



Bie çatia e ndërtesës së komunës në Prishtinë, lëndohet një person

PRISHTINË, 18 JANAR - Një grua është lënduar pasi është goditur nga materialet e rënda që kanë rënë nga kulmi i ndërtesës së komunës së Prishtinës në lagjen Arbëria të enjten, tha për Radion Evropa e Lirë drejtori i Qendrës së Mjekësisë Urgjente, Avdyll Pacolli. Pacolli tha se pas dhënies së ndihmës nga ekipi i Urgjencës, pacientja është dërguar me shenja jete në Klinikën Emergjente të Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës. “Flitet për një qytetare, viti i lindjes 2000, e cila ka pësuar një politraumë. Përveç kësaj, ka pësuar edhe një plagë në kokë. Ekipet tona kanë mbërritur për rreth gjashtë minuta në vendin e ngjarjes. Porsa kanë arritur në vendin e ngjarjes, ekipet tona kanë filluar ta trajtojnë pacienten, realisht kanë arritur të bëjnë pastrimin e plagës, kanë arritur ta trajtojnë, sepse ajo është politraumë dhe mund të ketë frakturë të shumta”, tha Pacolli, duke shtuar se kjo paciente është trajtuar në vendin e ngjarjes, më pas me autoambulancë, duke i

dhënë serum, pacientja është përcjellë me shenja vitale të jetës deri në Klinikën Emergjente. “Ajo është pranuar në Emergjencë dhe në këtë institucion ka filluar ta marrë trajtimin”, ka bërë me dije Pacolli. REL-i ende nuk ka arritur të marrë përgjigje nga Klinika Emergjente në QKUK lidhur me gjendjen aktuale të pacientes. Rastin e konfirmuar edhe Policia e Kosovës. “Rreth orës 13:00 është raportuar se në rrugën ‘Nora e Hotit’ në Prishtinë një person ka marrë lëndime si pasojë e goditjes nga materiale që janë shkëputur nga çatia e një objekti. Policia menjëherë ka dalë në vendin e ngjarjes, dhe mbështetur në informacionet e para, është raportuar për një person të lënduar, femër, e cila është dërguar në QKUK për trajtimin e nevojshëm mjekësor”, tha policia në një përgjigje për REL-in, duke shtuar se “aktualisht policia ka nisur punën për zbardhjen e plotë të të gjitha rrethanave që karakterizojnë ngjarjen”.



BE-ja i kërkon Serbisë t’i lejojë vizitat e zyrtarëve të Kosovës në Luginë të Preshevës

PRISHTINË, 18 JANAR - Bashkimi Evropian ka kërkuar nga Serbia t’i lejojë vizitat e zyrtarëve të Kosovës në tri komunat në jug të Serbisë, të cilat paralajmërohen në përputhje me marrëveshjen e arritur në dialog rreth vizitave të ndërsjella. Blloku ka kërkuar që Kosova ta respektojë në të njëjtën mënyrë këtë marrëveshje. Reagimi i BE-së vjen pasi ministrin të Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, në fillim të janarit iu refuzua leja për ta vizituar Luginën e Preshevës - komunat jugore në Serbi: Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc. “Vizita e ministrin të Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, në Serbi ishte



paralajmëruar në përputhje me marrëveshjen e dialogut rreth vizitave zyrtare. Prandaj, Serbia është dashur ta lejojë dhe ajo [vizitë] të realizohet”, u tha në

një përgjigje të Peter Stanos, zëdhënës i BE-së për punë të jashtme dhe siguri. Stano shtoi se “BE-ja vazhdon të bëjë ftesë për të dyja palët që në

tërësi dhe pa kushtëzime t’i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e arritura në dialog, përfshirë edhe marrëveshjet për vizitat zyrtare dhe lirinë e lëvizjes”. “Të gjitha mospajtimet duhet të zgjidhen përmes dialogut. BE-ja mbetet e gatshme t’ua lehtësojë palëve diskutimet për të gjetur zgjidhje”, tha zëdhënësi i BE-së. Më 4 janar Sveçla kishte planifikuar ta vizitonte Luginën e Preshevës, por vizita nuk iu lejua të bëhej nga autoritetet e Serbisë. Edhe në të kaluarën ka pasur raste kur Serbia, por edhe Kosova, kanë refuzuar të japin leje për vizita zyrtare në shtetet përkatëse. Më 27 nëntor të vitit 2021 autoritetet në Serbi kishin refuzuar kërkesën e katër

ministrave për vizitë dyditore në Luginë të Preshevës. Më herët, Kosova, po ashtu kishte refuzuar vizitën në Kosovë të shefit të Zyrës për Kosovën në Qeverinë serbe, Petar Petković. Në të gjitha këto raste, BE-ja gjithmonë i kishte kritikuar palët për refuzimin e dhënies së lejeve për vizita, duke u kërkuar atyre të lejojnë vizita të tilla në bazë të marrëveshjes së arritur për vizita të ndërsjella zyrtare. Sipas aranzhimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë për vizitat zyrtare, të arritura nën ndërmjetësimin e BE-së, këto vizita duhet të paralajmërohen përmes zyrtarëve ndërlidhës. Ndërkaq, autoritetet e shteteve përkatëse duhet t’i autorizojnë ato.

Për dy javë MINT-i pranoi 462 ankesa nga qytetarët për parregullsitë në treg

PRISHTINË, 18 JANAR - Për vetëm dy javët e para të këtij viti, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, gjegjësisht Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit, ka pranuar 462 ankesa nga qytetarët të cilët kanë raportuar parregullsitë të cilat i kanë hasur në treg. Prej tyre, 347 ankesa janë ndaj disa operatorëve kabllorë, shërbimet e të cilave janë të rregulluara me kontratë mes palëve në Republikën e Kosovës. “Angazhimi dhe përkushtimi maksimal i MINT për të qenë në krah me konsumatorin ka bërë

që këto ankesa të adresohen në kohë rekord tek institucionet relevante për trajtim të mëtejshëm, derisa vetë MINT do të sigurohet që secila ankesë ta marrë përgjigjen zyrtare në mënyrë që ky rast ta marrë epilogun e vet dhe qytetarëve, respektivisht konsumatorëve, t’u mbrohet e drejta e tyre e garantuar me ligj. Rritja e vazhdueshme e numrit të ankesave nga qytetarët në Departamentin e Mbrojtjes së Konsumatorit, e cila funksionon në kuadër të MINT-it, dëshmon njëherazi rritjen e besueshmërisë në institucione nga qytetarët. Për

këtë qëllim, MINT në vitin 2023 hartoi Ligjin e ri për Mbrojtjen e Konsumatorit, i cili u miratua nga qeveria dhe i cili fuqizon edhe më tej mbështetjen institucionale për të drejtën e konsumatorit në treg”, është bërë me dije në njoftimin e MINT-it. Sipas këtij njoftimi, vetëm gjatë vitit 2023 Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit pranoi mbi 3 000 ankesa. Numri më i madh i ankesave ishte në kategorinë e tregtisë, ku përfshihen: mospërputhja e çmimit, moskthimi i mallit, riimbursimi i mjeteve, mashtrimi i konsumatorit etj.



Ekonomia në trend të rritjes, shtysat dhe rreziqet

PRISHTINË, 18 JANAR - Shërbimet në tregti dhe teknologji informative (IT), konsumi dhe ndërtimtaria ishin faktorët kryesorë që ndikuan në parashikimet pozitive për rritje ekonomike në Kosovë, thonë ekspertë të fushës. Këta sektorë, sipas profesorit të ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, Berim Ramosaj, kishin “dinamikë relativisht të lartë të zhvillimit” në vitin 2023.

Në një raport të publikuar këtë muaj, Banka Botërore parashikoi rritje të brutoprodhimit të brendshëm në Kosovë për 3.9 për qind në vitin 2024 dhe 4 për qind më 2025. Sipas BB-së, vitin e kaluar, rritja ekonomike ishte 3.2 për qind, nga 3.5 për qind sa kishte qenë parashikimi.

Me parashikime edhe më pozitive për këtë vit doli Banka Qendrore e Kosovës, sipas së cilës, aktiviteti ekonomik në vend do të shënojë rritje për rreth 4.2 për qind. Kjo rritje “pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme - konsumi dhe investimet - si dhe eksporti”, thuhet në një shpjegim me shkrim të BQK-së dërguar Radios Evropa e Lirë.

Faktorët që i sfidojnë parashikimet pozitive

Ky institucion, megjithatë, thekson se janë disa faktorë, si tensionet gjeopolitike ose migrimi potencial i popullsisë, që krijojnë pasiguri dhe mund të ndikojnë negativisht në aktivitetin ekonomik.

Edhe Ramosaj thotë se parashikimi mund të ndryshojë, varësisht zhvillimeve në terren. “Këtu, te ne, besoj se sektori i shërbimeve dhe konsumi janë faktorët kyç që ndikojnë në rritjen ekonomike, pa e harruar edhe sektorin e ndërtimeve... Kur flas për shërbimet, flas për të gjitha format e shërbimeve, përfshirë edhe ato në fushën e IT-

së”, thotë ai, megjithëse veçon ndërtimtarinë si sektor që mund të lëkundet.

Sa i përket konsumit, ai “është rritur në kuptimin e shpenzimeve të qytetarëve për shportën familjare, sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve të jetesës në përgjithësi”, por liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës këtë vit mund të ndikojë në “ikjen e qytetarëve që krijojnë familje” dhe, rrjedhimisht, në rënien e kërkesës për objekte banimi, thotë Ramosaj.

Kjo nënkupton “më pak para në qarkullim”, thekson ai. Këtë shqetësim e shpreh edhe Blendi Hasaj nga Instituti për Hulumtime të Avancuara - me seli në Prishtinë. Sipas tij, sektori i ndërtimtarisë, i cili përfshin numrin më të madh të punëtorëve, është ndër kryesorët që ka ndikuar në rritjen ekonomike gjatë vitit 2023. Por, siç thotë ai, rrjedhat mund të ndryshojnë sivjet dhe vitin e ardhshëm.

Hasaj thotë se në dy vjetët e fundit nga Kosova kanë migruar rreth 40 mijë qytetarë dhe se ky trend migrimi pritet të rritet pas liberalizimit të vizave, nga 1 janari i këtij viti. Ai thekson se ekonomia e Kosovës është në fazën e zgjerimit dhe se rritja ekonomike prej 3.9-përqindësh ose 4 për qind është lehtësisht e arritshme nëse nuk ka pengesa të paparashikueshme. “[Për shembull], nëse kemi krizë me çmime në arenën ndërkombëtare, ajo mund të reflektohet drejtpërdrejt edhe në Kosovë dhe mund të shkaktojë rënie të konsumit. Edhe migrimi, i cili po shihet se po ndikon në tkurrjen e fuqisë punëtore në Kosovë, mund të ketë efekt negativ që ta ngadalësojë rritjen ekonomike në vend”, thotë Hasaj për Radion Evropa e Lirë.

Ajencia e Statistikave e Kosovës nuk ka ende të dhëna për vitet



2022 dhe 2023, por ato të vitit 2021 tregojnë se nga Kosova janë larguar mbi 42 mijë banorë për arsye të ndryshme, në mesin e tyre edhe punësimi.

Si reflektohet te qytetarët rritja eventuale ekonomike?

“Përmirësimi i nivelit të të ardhurave, rritja e punësimit, avancimi i cilësisë së jetesës etj.”, janë disa prej përfitimeve të mundshme, sipas BQK-së. Por, sipas Ramosajt, rritja ekonomike do të krijojte efekte konkrete pozitive vetëm në rast se do të ishte mbi 10 për qind. Ai thotë se rritja eventuale deri në 4 për qind mund të ketë efekte në aspektin makroekonomik të vendit, por jo edhe te qytetarët. “Kur bëhet fjalë për mirëqenien e qytetarit, me një shkallë të inflacionit që është jo aq ulët... [parashikimi për këtë rritje] nuk do të thotë se është ndonjë tregues i madh... Politikëbërësit mund të mburren, por nuk do të ketë ndikim shumë të madh në mirëqenien e qytetarëve”, thotë Ramosaj.

Hasaj vlerëson se rritja ekonomike do t’ia lehtësonte Qeverisë së Kosovës mundësitë e intervenimit në sektorë të caktuar, të cilët ajo i konsideron me prioritet. Në këtë kontekst, rritja ekonomike do të mund të

krijonte efekte për grupe të caktuara qytetarësh, thotë ai. “Nëse është prioritet mbështetja e eksportit, përfiton ndonjë grup i qytetarëve që janë ndërmarrës, që prodhojnë dhe që punësojnë në atë sektor. Mirëpo, nëse qeveria, për shembull, tani e ka prioritet arsimin, ose ta zëmë hapjen e ndonjë universiteti vetëm për teknologjinë informative, është një grup tjetër i qytetarëve që e vëren ndikimin drejtpërdrejt e kështu me radhë”, thotë Hasaj.

Për ta ruajtur trendin e parashikimeve pozitive ekonomike, shton ai, qeveria duhet të përqendrohet në investime kapitale që ndërlidhen me infrastrukturën e të bërit biznes.

Kanë qenë pikërisht investimet kapitale që ministri i Financave, Punës dhe Transfereve i Kosovës, Hekuran Murati, i ka trumbetuar si sukses të vitit të kaluar.

“Investimet kapitale janë kategoria që është rritur më së shumti në vitin 2023, me 32 % më shumë se në vitin 2022”, ka shkruar Murati në Facebook më 9 janar.

Në një konferencë të organizuar nga Ministria e Industrisë në dhjetor, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka lavdëruar ekonominë e vendit. “Me politikat tona zhvillimore po e rrisim ekonominë e vendit dhe po i

mbështesim si asnjëherë më parë qytetarët, bizneset dhe ndërmarrësit”, ka thënë Kurti. Ai ka shtuar se Qeveria e Kosovës ka mbështetur Fondin e Kosovës për garanci kreditore me 22.6 milionë euro, nga të cilat kanë përfituar bizneset.

Gjendja në shifra

Me 1.7 milion banorë Kosova ka një shkallë të papunësisë prej gati 12-përqindësh.

Paga mesatare bruto është 520 euro, ndërsa minimalja sillet nga 130 deri në 170 euro.

Shkalla e inflacionit në vitin 2023 ka qenë në trend të rënies, sipas Agjencisë së Statistikave - nga 12 për qind në janar në 2.3 për qind në dhjetor. Por vendi prej vitesh vuan nga deficit i lartë tregtar, pasi shumicën e produkteve e importon nga vendet fqinje ose ato të BE-së.

Në anën tjetër, Kosova është ndër vendet me popullsinë më të re në kontinent: moshë mesatare - sipas regjistrimit të fundit më 2011 - është 30.2 vjeç. Kjo moshë vlerësohet një prej faktorëve kryesorë që ka ndikuar në rritjen e sektorit të IT-së.

Aktualisht në Kosovë janë rreth 2 000 kompani që ofrojnë shërbime të teknologjisë informative dhe komunikimit, në krahasim me 930 sa kanë qenë para pandemisë Covid-19.

Rritja më e madhe e sektorit ka ndodhur në vitin 2022, kur janë shtuar mbi 700 kompani të reja. Gjatë kësaj periudhe është rritur edhe numri i punëtorëve në këtë sektor. Megjithatë, sipas BQK-së, investimet më të mëdha të huaja në Kosovë bëhen në sektorin e patundshmërisë dhe ato vijnë kryesisht nga diaspora e Kosovës. Kosova, po ashtu, pranon një shumë të madhe remitencash: rreth 7 miliardë euro në shtatë vjetët e fundit.

BQK-ja: Pagesat në Kosovë do të kryhen vetëm me euro

PRISHTINË, 18 JANAR - Banka Qendrore e Kosovës ka miratuar një rregullore për operacionet për paratë e gatshme, e cila thotë se monedha e vetme që lejohet për kryerjen e transaksioneve të pagesave me para të gatshme në Kosovë është euro.

Kjo rregullore do të hyjë në fuqi më 1 shkurt. “Valuta e vetme e lejuar të përdoret për kryerjen e transaksioneve të pagesave me para të gatshme dhe në sistemin e pagesave në Republikën e Kosovës është euro, si valutë e vetme edhe në kuptim të nenit 11 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neneve 16, 17 dhe 18 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës”, thuhet në nenin 35 të kësaj rregulloreje.

Në Kosovë, në të gjitha vendbanimet me shumicë serbe,

popullsia atje përdor dinarin serb për të kryer pagesa dhe ata që punojnë në institucionet serbe në Kosovë, i marrin edhe pagat me dinarë. Me dinarë paguhen edhe pensionet, sipas sistemit serb si dhe shtesat për fëmijë dhe ndihmat sociale.

Gjithashtu, në zonat ku banojnë serbët, dinarët përdoren në objektet tregtare, ndërkaq në katër komunat me shumicë serbe në veri, çmimet janë me dinarë. Në rregulloren e BQK-së thuhet se valutat joeuro mund të përdoren vetëm për t’u ruajtur “në formë fizike apo në llogaritë bankare” dhe me to mund të kryhen pagesa ndërkombëtare dhe këto valuta, po ashtu, mund të përdoren për këmbim.

Por këmbimi, sipas BQK-së, mund të kryhet vetëm përmes institucioneve të licencuara nga



ajo për këtë shërbim.

Deri më tani dinarët në Kosovë qarkullojnë përmes kompanisë publike serbe “Posta e Serbisë” e cila vepron në vendbanimet e banuara me serbë në Kosovë. Llogari në dinarë ka edhe në bankat “Postanska stedionica” (Kursimore e Postës) dhe “NLB

Komercijalna banka”.

Dinarët kanë ardhur në Kosovë nga Serbia përmes Bankës Kombëtare të Serbisë, e cila ka një kasafortë në Leposaviq, komunë në veri të Kosovës e banuar me shumicë serbe. Paratë atje janë transportuar nga kompania e transportit të parave

“Henderson”.

Në rregulloren e BQK-së thuhet se importi dhe eksporti i kartëmonedhave dhe monedhave metalike euro dhe valutave të tjera në Kosovë është e drejtë ekzekutive e saj.

Më herët çështjen e transaksioneve me valuta joeuro e ka ngritur edhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, i cili ka thënë se Kosova do t’i ndalë transaksionet me dinarë.

Qeveria e Kosovës nuk është deklaruar për këtë çështje.

Ndërkaq, i dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajčak, ka thënë për televizionin serb “Pink” se për përdorimin e dinarit në Kosovë ka biseduar me zëvendëskryeministrin e Kosovës, Besnik Bislimi, dhe për këtë çështje e ka njoftuar Brukselin.

Evropa pas Jacques Delor-it



Nga Thomas PIKETTY

Me vdekjen e Jacques Delors-it, presidenti i Komisionit Evropian nga viti 1985 deri në vitin 1995, ka përfunduar një kapitull në historinë evropiane. Ka ardhur koha për të bërë një vlerësim kritik të kësaj periudhe vendimtare, dhe për të nxjerrë mësim për të ardhmen, pak muaj përpara zgjedhjeve evropiane të qershorit 2024.

Të thuash se Evropa që ne njohim sot u formua gjatë kësaj periudhe do të ishte një nënvlerësim: me Aktin e Evropës së Përbashkët të vitit 1986 (që lejon lëvizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve), Direktivën Evropiane të vitit 1988 mbi liberalizimin e flukseve të kapitalit, si dhe Traktatin e Mاستrihtit të vitit 1992. Në veçanti, ishte Traktati i Mاستrihtit, i miratuar me një diferencë të ngushtë nga votuesit francezë në shtator 1992 (51% pro), ai që e transformoi ish-Komunitetin Ekonomik Evropian (KEE, i krijuar në 1957 nga Traktati i Romës) në Bashkimin Evropian (BE) dhe e pajisi atë me një monedhë të vetme. Siç ishte planifikuar në vitin 1992, euro hyri në fuqi në vitin 1999 për kompanitë dhe në vitin 2002 për individët.

Traktati i vitit 2005 për krijimin e një Kushtetute për Evropën – i refuzuar në Francë në referendum (55% votuan

kundër) dhe më pas i miratuar nga Parlamenti, pas disa ndryshimeve të vogla, në formën e Traktatit të Lisbonës në vitin 2007 – u kufizua në konsolidimin e vendimeve të marra ndërmjet viteve 1986 dhe 1992, dhe në konstitucionalizimin e parimeve të konkurrencës dhe lëvizjes së lirë, pa ndonjë risi të madhe. Kompakti Fiskal Evropian i vitit 2012 shtrëngoi kriteret e Mاستrihtit për borxhin dhe deficitet, që ishin përcaktuar në 1992, sërish pa ndonjë risi të domethënëse.

Për të kuptuar se sa shumë gjëra kishte “në lojë” gjatë negociatave vendimtare mes viteve 1985 dhe 1995, libri të cilit duhet t’i referohemi mbetet ai i botuar në vitin 2007, me autor Rawi Abdelal (Ndërtimi i Financës Globale). Bazuar në dhjetëra intervista të thelluara me aktorët kryesorë politikë dhe zyrtarë të lartë evropianë të kohës, veçanërisht Jacques Delors dhe Pascal Lamy, Abdelal analizon mjeshtërisht vizionet e të ardhmes dhe hapësirat negociuese të secilës palë.

E thënë përmbledhtaz, socialistët francezë vinin bast se krijimi i Euros dhe i Bankës Qendrore Evropiane, një institucion i fuqishëm federal që i merr vendimet me votë shumice, do të mundësonte me kalimin e kohës krijimin e një fuqie publike evropiane, në gjendje të rregullonte forcat

ekonomike, me më shumë efektivitet se sa qeveria majtiste franceze e unitetit, që doli nga zgjedhjet e vitit 1981. Për të arritur këtë rezultat, ata ranë dakord me kërkesën qendrore të kristian demokratëve gjermanë, të cilët mbronin liberalizimin absolut të rrjedhës së kapitalit, pa asnjë rregullim publik, dhe mbi të gjitha pa ndonjë taksim të përbashkët. Kjo ishte një çështje madhore, e cila ishte neglizhuar nga presidenti francez, François Mitterrand dhe nga vetë Delors, gjatë negociatave. Ishin hedhur themelet e kompromisit.

Tridhjetë vjet më vonë, rezultati i këtyre risive radikale është i përzierë. Nga njëra anë, Banka Qendrore Evropiane luajti një rol qendror në parandalimin e kolapsit pas krizës financiare të vitit 2008 dhe pandemisë së Covid-19. Pas disa gafave në fillimet e krizës greke dhe rënien e panevojshme në masa shtrënguese gjatë viteve 2012-2013, vendim-marrja me votë shumice i mundësoi Bankës Qendrore Evropiane që të kapërcente vetot (sidomos atë gjermane) dhe të mobilizonte me shpejtësi dhe efikasitet, shumë të konsiderueshme, për të stabilizuar ekonominë evropiane dhe zvogëlonte diferencat në normat e interesit brenda eurozonës. Askush nuk e di se çfarë do të kishte ndodhur pa monedhën e përbashkët, dhe duhet thënë se vendet nordike që mbetën

jashtë saj, nuk kanë ecur aq keq. E vërteta është se asnjë aktor politik i besueshëm nuk është duke propozuar një rikthim tek franga.

Në anën tjetër, është e vetëkuptueshme se vetëm prodhimi i parave nuk mund të zgjidhë të gjithë problemet. Veç kësaj, përfaqësuesit e bankave qendrore kanë qenë shumë më të gatshëm për të shpëtuar banka dhe bankierë, se sa për të investuar në arsim, shëndetësi dhe klimë. Në këtë mënyrë, ata kanë kontribuar për rritjen e përqendrimit të pasurisë, teksa më të pasurit përfitojnë prej fryrjes së tregut të aksioneve dhe aseteve të pasurive të paluajtshme, të cilat janë bërë të mundura prej blerjeve nga ana e qeverive dhe paratë publike, ndërkohë që kursimet e më të varfërve po fshihen prej inflacionit. Rregullat evropiane për lëvizjen e lirë të kapitalit, të parashtruara në vitin 1992, kanë rezultuar kaq ekstreme dhe destabilizuese, sa që edhe FMN vendosi pas krizave në Azi të viteve 1997 dhe 2008, për të futur disa forma të kontrollit të kapitalit, për rrjedhat e kapitalit në terma afatshkurtër.

Rregullat e reja evropiane kanë luajtur gjithashtu një rol të madh në përkeqësimin e shmangies së taksimit: shkurtime të pafundme të taksave të korporatës, zhvillimi i paaprecedentë i paraajsave fiskale dhe nëntaksimi strukturor i miliarderëve dhe

multimilionerëve. Politikisht, referendumet e viteve 1992 dhe 2005 kontribuan në mënyrë domethënëse për largimin e një pjese të klasës punëtore nga kutitë e votimit dhe nga e majta. Vota kundër në vitin 2005 në Francë, ishte parashikuesja më e mirë e ngritjes së partisë së ekstremit të djathtë Ribashkimi Kombëtar në vitin 2022, sidomos në qytetet e mesme të prekura prej deindustrializimit. Çfarë mund të bëjmë për këtë trashëgimi komplekse? Së pari duhet t’u propozojmë partnerëve tanë që të krijojnë një bërthamë të fortë brenda BE, e cila të jetë në gjendje të marrë vendime madhore për çështjet buxhetore, fiskale dhe mjedisore. Edhe nëse ky Bashkim Parlamentar Evropian nuk sheh dritën e diellit në të ardhmen e afërt, ai duhet të mbetet objektiv qendror.

Së dyti, deri kur të arrihet një kompromis, ai do të jetë padyshim thelbësor për të marrë masa të njëanshme përballë shmangieve fiskale, sociale dhe mjedisore, brenda dhe jashtë BE. Kjo do të shkaktojë kriza komplekse, të cilat mund të kapërcehen nëse ndjekim një rrugë ndërkombëtare të qëndrueshme, dhe janë ndoshta të pashmangshme nëse duam të dalim nga bllokimi ku ndodhemi.

(Në shqip nga bota.al)



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Gazeta ‘AS’: Zhegrova është një nga sensacionet në Francë

MADRID, 18 JANAR - Gazeta spanjolle “AS” i ka kushtuar një artikull special yllit të Përfaqësueses së Kosovës dhe Lille, Edon Zhegrovës. Zhegrova ka qenë një nga emrat më të përfolur javët e fundit pas një forme fantastike me klubin francez, Lille, por edhe në gjithë sezonin vjeshtor. Në 26 ndeshje të luajtura në të gjitha garat, Zhegrova ka kontribuar me 7 gola


dhe 7 asistime por, përveç tyre, prishtinasi ka edhe një aftësi tjetër që e bën të përflitet shumë. Bëhet fjalë për driblimin të cilin ylli i Kosovës e ka dhunti dhe ka përfunduar gjithmonë në vendet e larta në listën e dribluesve më të mirë në futbollin evropian. Dhe pikërisht për driblimet e tij, gazeta spanjolle AS ka bërë një artikull ku i ka

dhënë jehonë duke e cilësuar si një sensacion dhe driblues zbavitës. “Kështu luan dribluesi më zbavitës në ligat e mëdha. Edon Zhegrova është sulmuesi anësor i djathtë kosovar, i cili luan për Lille në Ligën 1 dhe është një nga sensacionet në Francë. Aftësia e tij në driblim po lë figura rrëqethëse”, thuhet në përshkrimin e videos nga gazeta “AS”.



Ndërron jetë ish-volejbollistja Vlora Hyseni

PRISHTINË, 18 JANAR - Volejboli i Kosovës sot është në zi, pasi ka ndërruar jetë volejbollistja Vlora Hyseni. Federata e Volejbollit të Kosovës me anë të një telegram ngushëllimi ka ngushëlluar familjen dhe miqtë e Vlorës, derisa ka konsideruar se ajo do të lë një boshllëk të madh në volejball, por edhe në sportin në përgjithësi. “Me dhimbje e morëm lajmin e hidhur për kalimin në amshim të ish-volejbollistes Vlora Hyseni. Vlora, që kontribuoi drejtpërdrejt në sportin kryeqytetas, duke qenë pjesë e Klubit Mabetex e më vonë edhe Kolegjit AAB, do të kujtohet përherë për pozitivitetin dhe profesionalizmin. Humbja e Vlorës lë boshllëk në komunitetin tonë, por ajo do të mbetet mes nesh përherë për kujtimet e mira që na la. FVK-ja i shpreh ngushëllimet e singerta familjes Hyseni, miqve e dashamirëve, me të cilët rrethohej në jetë e karrierë. E kujtofsi sa të rroni!”, thuhet në telegramin e FVK-së.



SHKURT

Dresheviqi transferohet në Japoni

Futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Ibrahim Dresheviq, ka nënshkruar kontratë me klubin japonez Machida. Klubi japonez ka njoftuar për transferimin e futbollistit “dardan”, por nuk ka dhënë hollësi të tjera. “Ju njoftojmë se është vendosur që Dresheviq t’i bashkohet klubit me transferim të përhershëm nga Fatih Karagümlük i Turqisë”, thuhet në njoftimin e klubit japonez. Ndërsa Dresheviq është shprehur i lumtur me këtë transferim. “Jam shumë i lumtur që i bashkohem këtij klubi të madh. Jam i emocionuar që luaj për ekipin dhe tifozët. Është një përvojë e re për mua dhe familjen time. Unë dua që ky klub të fitojë. Do të luaj”, ka thënë Dresheviq.

Zeneli largohet nga Adana Demirspor

Klubi turk Adana Demirspor ka njoftuar zyrtarisht se sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës, Arbër Zeneli, është larguar nga skuadra e tyre. Zeneli u transferua në verë tek Adana Demirspor në tentim për ta rigjetur formën pas një sezoni katastrofik në Ligën 1 me Reims, ku pati edhe disa lëndime të rënda. Megjithatë, pa i mbushur mirë gjashtë muaj, sulmuesi anësor i Kosovës është larguar nga klubi turk. Është vetë klubi që ka njoftuar se 28-vjeçari ka shkëputur njëanshëm kontratën dhe tani është lojtar i lirë. “Arbër Zeneli ka shkëputur në mënyrë të njëanshme kontratën me Adana Demirspor”, thuhet në njoftimin e klubit turk. Gjatë sezonit vjeshtor tek Adana Demirspor, Zeneli luajti 13 ndeshje në të gjitha garat, ku pati vetëm një asistim.

Bejtullai i bashkohet zyrtarisht Dritës

Skuadra e Dritës ka konfirmuar se Egzon Bejtullai është lojtari i tyre më i ri. Klubi gjilanas bëri me dije se lojtari me të nënshkruar kontratën i është bashkuar ekipit në Turqi. “Kemi kënaqësinë t’ju njoftojmë që kemi arritur marrëveshje për transferimin e Egzon Bejtullait në radhët tona. Egzoni i është bashkuar ekipit në Antalya të Turqisë ku është pritur nga drejtori sportiv Valon Zymeri i cili i dëshiroi mirëseardhje dhe shumë suksese së bashku. Egzoni ka nënshkruar marrëveshje me klubin për dy vjet e gjysmë dhe do të jetë me ne deri në qershor të 2026”, thuhet në njoftimin e Dritës.

Chelsea kërkon 50 milionë sterlina për Brojën

LONDËR, 18 JANAR - Shumë klube janë duke u interesuar për sulmuesin shqiptar Armando Broja. 22-vjeçari po kërkohet nga West Hami, Fulhami dhe Wolverhamptoni. Këto skuadra janë vënë në gjurmët e

shqiptarit, por për to nuk do të jetë e lehtë. Chelsea ka bërë me dije se për ta lënë të lirë Brojën kërkon 50 milionë sterlina. Lajmin e konfirmoi "Daily Telegraph". Broja ka një kontratë deri në vitin 2028 me londinezët.

Armando Broja u rikthye pak kohë më parë nga një dëmtim i gjatë dhe këtë sezon ka luajtur në total në 17 ndeshje e ka realizuar 2 gola. Shqiptari nuk ka luajtur shumë ndeshje si titullar dhe shpesh është zëvendësuar,

por shpesh ka bërë paraqitje të mira. Për Brojën janë interesuar edhe Inter në Itali, por të gjitha skuadrat që dëshirojnë shërbimet e shqiptarit duhet të paguajnë 50 milionë sterlina te Chelsea.



Mbappe: I meritoj paratë që fitoj, nuk ia kam vjedhur askujt

PARIS, 18 JANAR - Kylian Mbappe ka folur në reportazhin "Envoye Special", i cili transmetohet në "France 2". Ai flet për dëshirën për të krijuar familje, racizmin, viktimë e të cilit ishte, zhgënjimin e tmerrshëm që jetoi gjatë finales së Kupës së Botës 2022 kundër Argjentinës, dëshirën për të garuar në Lojërat Olimpike 2024, marrëdhëniet me prindërit, të ardhurat e tij. Çështja e së ardhmes së tij, e cila është në qendër të vëmendjes, nuk trajtohet, megjithëse futbollisti pranon se PSG-ja dëshiron ta dijë sa më shpejt se çfarë do të bëjë, nëse do të rinovojë apo jo. Mbappe e njuh atë që do të donte të bënte në jetën e tij të përditshme: "Të shkoj të ha qetësisht në një restorant, të dal me miqtë, por të mos lejoj askënd të më shohë... Të nesërmen, një mëngjes i mirë në diell, hipur mbi tarracë. I admiroj gjërat e thjeshta në jetë". Sa i



përket të ardhurave vjetore, ai nuk e mohoi se fiton rreth 100 milionë euro në vit. "E vërteta është se nuk e di saktësisht... Në moshën 12-vjeçare kam menduar gjithashtu se ka shumë para në futboll. Unë i meritoj paratë që fitoj, nuk ia kam vjedhur askujt. Kështu funksionon bota e futbollit", ka

shtuar ai. Nëna e tij, Fayza Lamari, është pjesë thelbësore e këtij reportazhi, së bashku me Delphine Verheyden, avokaten e Kylanit Mbappes. "Nuk ka faj apo turp. Nëse do të na kishim afruar 1 miliard euro, do t'i kishim pranuar, sepse është sistemi që e dëshiron këtë", thotë ajo për rinovimin e Kylianit me PSG-në.

Bostoni e Minnesota udhëheqin dy Konferencat, humbasin Milwaukee e Miami



BOSTON, 18 JANAR - Bostoni ruan kreun e renditjes në Konferencën e Lindjes pas fitores me rezultat 118-97 ndaj San Antonios. Ndeshje pa shumë histori, ku u dallua Tatum, autor i 24 pikëve. Fitorja e dytë radhazi për lakersat, që mundi me rezultat 127-110 Dallasin. Tre lojtarë të lakersave realizuan 82

pikë (Russell 29, Davis 28, James 25), duke i bërë të pavlefshme 33 pikët e Donçiqit për teksanët. Toronto, falë 28 pikëve të Trentit, mundi me shifrat 121-97 Miamin, duke synuar zonën "play-off" në Lindje. Në krye të renditjes në Konferencën e Perëndimit qëndron Minnesota, që mundi

Detroitin (124-117). Towns e Edwards realizuan nga 27 pikë secili për Minnesotan, ndërsa 32 pikët e Ivey mbetën për statistikë. Zhgënjëu ekipi i Milwaukeees, që u mund nga Clevelandi (135-95), ndeshje e dominuar nga vendasit, ku u dalluan Niangu me 33 pikë e Mitchell me 31. Fitore në sekondat e fundit korri Atlanta, që falë 26 pikëve të Murrayt, mposhti me rezultat 106-105 Orlandon.

REZULTATET

Detroit - Minnesota	117-124
Atlanta - Orlando	106-104
Boston - San Antonio	117-98
Cleveland - Milwaukee	135-95
New York - Houston	109-94
Toronto - Miami	121-97
New Orleans - Charlotte	132-112
Lakers - Dallas	127-110
Utah Jazz - Golden State	(e shtyrë)
Portland - Brooklyn	105-103

SHKURT

FShF-ja do ta zbatojë sistemin VAR në disa ndeshje të Kategorisë së Parë

Federata Shqiptare e Futbollit ka bërë me dije se së shpejti do ta nisë implementimin e sistemit VAR edhe për disa nga ndeshjet e Kategorisë së Parë. Përfshirja e sistemit VAR edhe në ndeshjet e kësaj kategorie ka qenë një objektiv i hershëm i FShF-së ndërkohë që ky sistem përdoret në kategorinë "Abissnet Superiore" që prej sezonit 2021-2022. Sistemi VAR tashmë përdoret rregullisht prej tre sezonesh ashtu si edhe në Kupën e Shqipërisë, duke filluar që nga faza çerekfinale e deri në finalen e madhe. FShF-ja është duke bërë përgatitjet e fundit që përfshirja e sistemit VAR të nisë menjëherë në pjesën e dytë të sezonit për disa ndeshje të Kategorisë së Parë. Vlen të theksohet se sistemi VAR në Kosovë veçse ka filluar të përdoret në disa nga ndeshjet kryesore të Ligës së Parë.

Lenjani rikthehet në Zvicër

Futbollisti me prejardhje nga Kosova, Ermir Lenjani, rikthehet në Zvicër, por këtë herë në Challenge League, ose kategorinë e dytë të futbollit helvet. 34-vjeçari ka ndërprerë para kohe kontratën me Umranyespor dhe ka firmosur me FC Schaffhausen, skuadër ku shërben si drejtor sportiv ish-sulmuesi shqiptar i Zvicrës, Admir Mehmedi. Lenjani është rritur te Winterthur në Zvicër para se të spikaste te St. Gallen. Në 2015-n ai u transferua në Francë te Rennes dhe një vit më vonë te Nantes para se të rikthehej në Zvicër për t'i veshur fanellat e klubeve si Sion dhe Grasshoppers. Lenjani numëron 45 ndeshje me fanellën kuqezi të Kombëtares Shqiptare dhe 6 gola të shënuar, teksa ka qenë pjesë e skuadrës që përfaqësoi vendin në Evropianin e Francës.

Manaj vendimtar për fitoren e Sivasporit

Rey Manaj vazhdon të jetë vendimtar me gola për skuadrën e tij në Turqi. Sulmuesi i Kombëtares shqiptare shënoi edhe në Kupë, gol që rezultoi vendimtar, pasi kualifikoi Sivasporin në 1/8 finale. Manaj u aktivizua në minutën e 60 dhe në të 81-n realizoi me një gjuajtje nga jashtë zonës. Ishte ky goli që i dha fitoren 3-2 skuadrës së tij, që avancoi më tej në Kupë. Manaj po kalon një formë të shkëlqyer, teksa ky ishte goli i katërt në Kupë, ndërsa në 8 raste ka festuar dhe në kampionat. Forma e tij e mirë ka vënë në siklet edhe trajnerin Sylvinho për ta rikthyer në ekipin kombëtar.

Interi, Arsenali dhe Chelsea në garë për Benzeman

Sulmuesi francez Karim Benzema dëshiron të largohet nga Arabia Saudite pas vetëm disa muajsh të kaluar në Lindjen e Mesme. Ish-asi i Realit nuk po ndihet rehat në Al-Ittihad dhe ua ka bërë me dije drejtuesve të klubit se dëshiron të rikthehet në futbollin evropian. Futbollisti me prejardhje algeriane po kërkohet nga disa klube të njohura, ku Interi shfaqet i pari interesimin për të. Por jo vetëm Interi, veteranin e sulmit e duan edhe Arsenali dhe Chelsea, ndërsa ditë më parë u fol edhe për Manchester Unitedin, por që "Djajtë e Kuq" duket se janë tërhequr tashmë. Pra, ish-përfaqësuesi francez mund të përfundojë në Premierligë ose në Serinë A.

Zanetti: Superkupa është një objektiv i rëndësishëm

Zëvendës-presidenti i Interit, Javier Zanetti, ka bërë bilancin pak orë para nisjes së Interit për në Riad, ku zikaltrit do të luajnë kundër Lazios të premtën në gjysmëfinalen e Superkupës së

Italisë. Zikaltrit synojnë ta përsërisin suksesin e dy viteve të fundit dhe të marrin sërish në shtëpi trofeun, siç ka treguar edhe "Pupi" në intervistën e tij për "Planetwin365.news".

"Është një objektiv i rëndësishëm dhe do të duhet të japim më të mirën, sepse është një trofe që pasuron historinë e klubit që e fiton. Të gjitha fitoret e mia në këtë kompeticion

erdhën pas ndeshjeve emocionuese. Më kujtohet ajo e vitit 2006, kur përmbysëm Romën nga 0-3 në 4-3. Përsëri me Romën, më kujtohet veçanërisht ajo e vitit 2008, të

cilën e fituam me penallti. Më takoi mua ta ekzekutoja penalltinë e fundit, që ishte penalltia e vetme që kam realizuar në karrierë", ka thënë Zanetti.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:	Zyrtar për Operacione të Investimeve
Grada e pozitës:	gjashtë (6)
Kohëzgjatja e punësimit:	pa afat
Pozita:	e përhershme
Departamenti:	i Menaxhimit të Mjeteve dhe Rezervave
Divizioni:	i Investimeve
Raporton tek:	Udhëheqësi i Divizionit të Investimeve

Përmbledhje e Detyrave dhe Përgjegjësisë:

- Kryen dhe kompletën të gjitha operacionet dhe transaksionet e investimeve në bashkëpunim me Zyrtarët tjerë në divizion;
- Përgatitë raporte ditore, javore për Divizionin e Investimeve në pajtim me zbatimin e Politikës Investive;
- Ndihmon në përgatitjen e raporteve për Komitetin e Investimeve në rast të mungesës së Zyrtarit të Analizave Investive;
- Kujdeset për operacionet ditore të investimeve;
- Kontrollon gjendjen e llogarive tona ditore (llogaritë nostro të BQK-së) në baza ditore;
- Koordinon aktivitetin e investimeve me Zyrën e Pasmë dhe Auditimin e Brendshëm lidhur me të gjitha transaksionet e procesuara në i-flex;
- Pranon informata mbi pagesat hyrëse dhe dalëse për klientët e BQK-së dhe përgatitë futjen e të gjitha transaksioneve në i-flex (sistemi bankar i BQK-së);
- Proceson ndryshimin e normës referuese në i-flex (sistemin banker të BQK-së);
- Mban kontakt me zyrtarët e llogarive dhe dilerëve të bankave me të cilat bashkëpunon BQK;
- Kryen procesimin e të gjitha transaksioneve bazuar në vendimet investive;
- Kryen përpilimin e listave të personave kontaktues (të autorizuar) me të cilët bashkëpunon BQK brenda dhe jashtë vendit sipas nevojës;
- Grumbullon, monitoron dhe analizon të gjitha informatat relevante në lidhje me tregjet financiare botërore në baza ditore nga Bloombergu;
- Informon në baza ditore lidhur për lëvizjen e normave të interesit nga ana e bankave me të cilat bashkëpunon BQK;
- Përcjellja në baza ditore e ndryshimit të normave të kamatave në treg dhe mundësinë e ndryshimit të normës së instrumentit depozitar (deposit facility rate);
- Kryen përgatitjen e raporteve (ad hoc raporteve) të Zyrës Frontale;
- Asiston në përgatitjen periodike të komenteve mbi tregjet, përgatitë ad hoc përmbledhjet në ngjarjet ekonomike.
- Detyra tjera të cilat caktohen kohë pas kohe nga Mbikëqyrësi.

Dituritë e kërkuara:

- Diplomë universitare në Fakultetin Ekonomik, Banka dhe Financa apo Administrim Biznesi;
- Përvoja në financa, investime, kontabilitet apo operacionet e thesarit;
- Rrjedhshmëri në të folur dhe në të shkruar e gjuhës shqipe dhe/ose serbe;
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi.

Përvoja e kërkuar:

- Minimum dy (2) vite përvojë pune profesionale në financa, kontabilitet, thesar, zyre të auditimit apo autoritete rregullative;
- Përvoja në banka apo sektorin financiar është e preferushme.

Kërkesat e posaçme:

- Aftësi komunikuese në të shkruar si dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve sipas prioriteteve;
- Aftësi të shkëlqyera kuantitative dhe analitike;
- Njohuri të shkëlqyera në përdorimin e sistemeve kompjuterike, MS Office të ngjashme;
- Vëmendje në detaje, në formulime të qarta dhe saktësi;
- Vetëiniciativë dhe gatishmëri për punë ekipore;
- Ruajtja e fshehtësisë afariste.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **02 shkurt 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org



OGLAS O SLOBODNOM RADNOM MESTU

Naziv radog mesta:	Službenik za investicione operacije
Stepen pozicije:	šest (6)
Trajanje zaposlenja:	bez roka
Pozicija:	stalna
Odeljenje:	za upravljanje sredstvima i rezervama
Odsek:	za investicije
Izveštava:	šefu Odseka za investicije

Sažetak dužnosti i odgovornosti:

- Obavlja i završava sve operacije i investicione transakcije u saradnji sa drugim službenicima u odseku;
- Priprema dnevne i nedeljne izveštaje za Odsek investicija u skladu sa sprovođenjem Investicione politike;
- Pomaže u pripremi izveštaja za Investicioni komitet u odsustvu službenika za analizu investicija;
- Vodi računa o svakodnevnim investicionim operacijama;
- Proverava stanje naših dnevnih računa (nostro računi CBK-a) na dnevnim osnovama;
- Koordinira investicionu aktivnost sa Pozadinskom kancelarijom i internom revizijom u vezi sa svim transakcijama obrađenim u i-flex- u;
- Prima informacije o ulaznim i odlaznim uplatama za klijente CBK-a i priprema unos svih transakcija u i-flex (bankarski sistem CBK-a);
- Obraduje promenu referentne stope u i-flex- u (bankarski sistem CBK-a);
- Održava kontakt sa službenicima računa i dilerima banaka sa kojima sarađuje CBK;
- Vrši obradu svih transakcija na osnovu odluka o investiranju;
- Sastavlja liste kontakt osoba (ovlašćenih) sa kojima CBK sarađuje unutar i van zemlje po potrebi;
- Prikuplja, prati i analizira sve relevantne informacije o svetskim finansijskim tržištima na dnevnoj osnovi od Bloomberg-a;
- Informiše na dnevnim osnovama o promeni kamatnih stopa od strane banaka sa kojima sarađuje CBK;
- Praćenje na dnevnim osnovama promene kamatnih stopa na tržištu i mogućnosti promene stope depozitnog instrumenta (deposit facility rate);
- Vrši izradu izveštaja (ad hoc izveštaji) Frontalne kancelarije;
- Pomaže u periodičnoj pripremi komentara na tržištima, priprema ad hoc sažetke o ekonomskim događajima.
- Druge dužnosti koje sa vremena na vreme dodeljuje supervizor.

Potrebna znanja:

- Univerzitetska diploma Fakulteta za ekonomiju, bankarstvo i finansije ili Poslovnju administraciju;
- Iskustvo u poslovanju finansija, investicija, računovodstva ili trezora;
- Tečno govorenje i pisanje albanskog i/ili srpskog jezika;
- Poznavanje engleskog jezika je prednost.

Potrebno iskustvo:

- Najmanje dve (2) godine profesionalnog radnog iskustva u finansijama, računovodstvu, trezoru, kancelariji za reviziju ili regulatornim organima;
- Poželjno je iskustvo u bankarstvu ili finansijskom sektoru.

Posebni zahtevi:

- Sposobnosti pismene komunikacije kao i sposobnost rešavanja problema prema prioritetima;
- Odlične kvantitativne i analitičke sposobnosti;
- Odlično poznavanje korišćenja računarskih sistema, MS Office i slično;
- Pažnja prema detaljima, jasan tekst i tačnost;
- Samoinicijativa i spremnost za timski rad;
- Čuvanje poslovnih tajni.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK-a za apliciranje;
- Propratno pismo (motivaciono) u kojem je naglašeno interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrde poslodavca ili drugi relevantni dokumenti koji služe za dokazivanje držane pozicije i radnog iskustva, bez kršenja relevantnih akata za zaštitu ličnih podataka);
- Izveštaj Fonda penzijskih štednji Kosova (Trusta)** za relevantni period, ili poresku potvrdu Poreske administracije (PAK) kada se izveštaj Trusta ne primenjuje zakonski;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti službeno priznate/ nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Postupak apliciranja:

- Krajni rok za apliciranje je **2. februar 2024. godine**.
- Apliciranje se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko službene internet stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Nijedan drugi oblik apliciranja neće biti razmatran.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti preko službene internet stranice: www.bqk-kos.org.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021, Zyra e shitjes me datën 17.10.2023 bënë shpallje publike për dhënin e pronës së paluajtshme me qira.

Shpallje Publike
T-24-1

Autoriteti Kontraktues (AK): Trepça SH.A.
Adresa e AK: Parku Industrial
MITROVICË
40000

Personi Kontaktues: Behxhet Nimani
E-mail: behxhetnimani@hotmail.com
Telefoni: +381 28 538 050
Faks: +381 28 539 202

Shpallja Publike

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qira e hapësirave të objektit Puntoria e Re në Kishnicë

Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet Çmimi më i lartë
Data e shpalljes: 18.01.2024
Sqarimi: deri me 31.01.2024
Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 31.01.2024
Behet ne e-Mail: poshtë shënuar ose në zyrën e Divizioni i shitjes dhe qirasë.

Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur) (Originali dhe Kopja)

Afati i fundit i dorëzimit: 31.01.2024 në 11:00
Vendi i dorëzimit: Divizioni i shitjes dhe qirasë Trepça Sh.A.
Parku Industrial, Mitrovicë

Kërkesat minimale të kualifikimit:

- 1. Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të entitetit.
- 2. Kopje të certifikatës së regjistrimit për TVSH (vetëm për ofertuesit vendor)
- 3. Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonës në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të njoftimit për kontratë.
- 4. Nuk ka obligime ndaj Trepçës te pa paguara.

Shënime shtesë:

Çmimi i ofertës: Çmimi i ofruar nga O.E të interesuar do të jetë më i madhe apo i barabarte me çmimin e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues - Trepça Sh.A.
Obligimet: Ofertuesi fitues do të bartë të gjitha obligimet e investimeve si dhe te gjitha shpenzimet administrative, komunale dhe shpenzimet tjera të cilat dalin mbas lidhjes së kontratës.
Oferta: Duhet të përfshijë çmimin për m² duke përfshirë TVSH-në dhe Çmimin total shih Aneks1.
Pagesa: Të gjitha pagesat do të bëhen në EURO, pa ndalesë, kundërkërkesë ose çfarëdo zbritje në llogarinë bankare të Trepça Sh.A.
Operatorët ekonomik: që nuk i paraqesin të gjitha të dhënat për formimin e çmimit Aneks 1 dhe deklarimi Aneksi 2 Ofertat e tyre nuk do të shqyrtohet.

Aneksi 1 OFERTA

Emri i OE:	
Loti	
Kodi (T?)	

Përmbledhje		Çmimi
a	m ²	
b	Çmimi për metër	
c = a * b	Çmimi me TVSH	

Tatimi në qira prej 9% gjithashtu bije në barrë të qiramarrësit dhe pagesën e saj e bënë qiramarrësi

Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: *operatorin ekonomik që paraqitet* deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Rregulloren për dhënie me qira te pronës se paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në rregulloren dhe siguroj se jam i përshtatshëm të marrë pjesë.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbytësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
E-mail:	
Tel:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Aneks 3. Pjesëmarrja

Pjesëmarrja - Marrja e Aplikacionit mund te behet deri me datën 01.11.2023 për mes e-mail ose në Zyren e Shitjes.

Aneks 4. Përshkrimi i Aseteve

Përshkrimi i aseteve të shënuara më poshtë shërbejnë vetëm për qëllime të informimit dhe Autoriteti Kontraktues nuk ofron garanci të saktësisë së përshkrimit. Këto asete jepen në kushte të gjendjes aktuale “ashtu siç janë dhe ku janë” dhe autoriteti kontraktues nuk ofron Garancion në lidhje me gjendjen e aseteve. Tenderuesi bartë rrezikshmërinë e plotë për gjendjen e aseteve.

Objekti është i ndarë në lote,

Trepça Sh.A. përmes këtij njoftimi përcakton kushtet dhe termet dhënës me qiratë objekteve dhe hapësirave sipas tenderit me metodën e çmimit ekonomikisht më të lartë, bazuar në parametrat e poshtëshënuar që përcaktojnë formimin e çmimit ekonomikisht më të lartë.

DHËNIE ME QIRA E HAPËSIRËS

Oferta duhet të jepet për m² dhe llogaritja përfundimtare në faturim

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Nexhdet Hoxha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Agron Sylja nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Arbër Ahmeti nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10, 11, 12 dhe diplomën e sh.m. "Gjon Nikoll Kazazi" Gjakovë.

- Alfred Pnishi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10, 11, 12 të sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Ulvije Rexha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m. "Mustafa Bakija" nga kl. I-IX.

- Rasim Kokalla nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e A.P. "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



INVITATION TO TENDER

D&D Business Support Center – D&D BSC is implementing the project "Provision of services in the establishment of the grant scheme for Start-Ups, Micro, and Small Enterprises (MSEs), including business consultancy services" with reference no.: 10074148 with the aim to create employment and provide new skills and knowledge by encouraging entrepreneurship and providing opportunities for establishing and/or reviving micro, small & medium enterprises/businesses through the provision of small grants, along with business consultancy support.

This project is part of the "Cultural Heritage as a Driver for Economic Revival of Janjevë/Janjevo" project, which is funded by the European Union Office in Kosovo and Kosovo's Ministry of Culture, Youth, and Sports and implemented by United Nations Development Programme (UNDP) in Kosovo.

D&D BSC invites Bidders to submit, free of charge, and without obligation on part of D&D BSC, a bid on offering Tools and Equipment tailored packages for beneficiaries.

Interested bidders, can send a request for Terms of Reference via email with reference number 10074148 in the subject line to procurement@dd-bsc.com.

The responsible D&D BSC officer will provide you with Terms of Reference within a day.

Bidders are not allowed to contact or discuss any aspect of the tender with D&D BSC before closing of the tender as it will lead to automatic disqualification.

Request for Terms of Reference must be sent by e-mail to procurement@dd-bsc.com before January 22nd, 2024 at 23:59.

Application deadline is on February 1st, 2024 at 16:00 hrs.





TRADITË QË NGA 1992

